




Nr. 56 prot
Dt. 16/12/2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



VENDIM

Nr. 44, datë 15.12.2022

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR UJITJE, TË BASHKISË VAU DEJES,
ME VENDNDODHJE: FSHATI NARAC, PËRROI TAMËZ NË
BASHKINË VAU I DEJES, QARKU SHKODËR.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për ujitje, të Bashkisë Vau Dejes, me vendndodhje: Fshati Narac, Përroi Tamëz në Bashkinë Vau i Dejes, Qarku Shkodër.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri i burimit ujor: Përroi Tamëz

Vendndodhja e burimit ujor (KRGJSH)

Pika e furnizimit me ujë i projektit të ujitjes sipas monitorimit në terren të ZABU Drin – Bunë:

-X= 470019; Y= 4652641; Z= 29 m.m.n.d

Sipërfaqja e parcelës që do ujitet: $S=550$ ha

Prurja e ujit e miratuar: $Q = 650$ l/sek

Volumi i ujit i miratuar në vit $V_{\text{vjetore}} = 2\,000\,0000$ m³

Prurja mesatare vjetore: $Q_{\text{mes-vjet}} = 2790$ l/sek

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH):

-X1=468384; Y1= 4647922; Z1= 16 m.m.n.d

-X2= 467518; Y2= 4648784; Z2= 16 m.m.n.d

Prurja që shkarkohet: $Q= 650$ l/sek³

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

